VENDIM
Nr. 198, datë 3.9.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" SHA (FTL SHA) NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a. (FTL sh.a.), në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. ka përcjellë dokumentacionin për transferimin dhe licencimin e shoqërive të kontrolluara nga ana e saj. Ndër to, është edhe dokumentacioni i shoqërisë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a. (FTL sh.a.), për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.5.2018, "Furnizuesi i tregut të lirë" (FTL sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Shoqëria "Furnizuesi i tregut të lirë" (FTL sh.a.) është themeluar si shoqëri e kontrolluar, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues dhe shoqërisë mëmë. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 130, datë 4.6.2018, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a. (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, në zbatim të nenit 10, pikat 8 dhe 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", me shkresën nr. 55/34 prot., datë 13.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar lidhur me aplikimin e bërë nga ky subjekt dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të rregullores sipërcituar, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a. (FTL sh.a.), për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 355/1 prot., datë 17.5.3018, ERE i ka kërkuar aplikuesit plotësim të dokumentacionit dhe, me shkresën e datës 30.5.2018, protokolluar me tonën nr. 355/3 prot., "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a. ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për llogari të shoqërisë së kontrolluar "Furnizuesi i tregut të lirë" (FTL sh.a.).

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, "Përcillet dokumentacioni ...", Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. ndër të tjera bën me dije se "transferimi i personelit për këtë shoqëri", Furnizuesi i tregut të lirë" (FTL sh.a.), është në proces. Për rrjedhojë, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, do të plotësohet në vijim".

- Aplikimi i shoqërisë "Furnizuesi i tregut të lirë" (FTL sh.a.) plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar kryesisht me përjashtim të listës së personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë” sh.a. (FTL sh.a.), në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë” sh.a. (FTL sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri “Furnizuesi i tregut të lirë” (FTL sh.a.) nga struktura përkatëse.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti